

ROLI I REDAKTORËVE NË MBROJTJEN E
INTEGRITETIT TË MEDIAVE NË KOSOVË

LUFTA PËR INTEGRITET PROFESIONAL NË MES TË SUNDIMIT TË DOBËT TË LIGJIT

ISUF BERISHA

HYRJE

Legjislacioni i Kosovës për media është relativisht i mirë dhe në përgjithësi në përputhje me frymën e standardeve europiane dhe ndërkombëtare që garantojnë lirinë e shprehjes dhe media të lira. Mirëpo, zbatimi i dobët i tij vazhdon të mbetet problem serioz.¹ Për pasojë, gazetarët dhe redaktorët janë shumë pak të mbrojtur ose *de facto* të pambrojtur nga tendencat e vazhdueshme për ndërhyrje dhe trysni politike dhe ekonomike.

Gazetarët dhe redaktorët kosovarë paguhen dobët madje edhe sipas standardeve të Kosovës, ndërsa shumica e tyre punojnë pa kontrata pune.²

Ky raport paraqet gjetjet e një hulumtimi mbi situatën e redaktorëve të mediave në Kosovë. Roli i redaktorëve në mbrojtjen e integritetit të mediave të tyre ka qenë çështje udhëheqëse e këtij hulumtimi. Në studim janë tematizuar aspektet legale, ekonomike dhe politike të situatës së mediave dhe redaktorëve të tyre. Poashtu janë shqyrtuar dhe analizuar edhe gjendja arsimore dhe situata profesionale e redaktorëve. Për t'i kuptuar më mirë këto çështje ato poashtu janë vendosur në kontekst historik. Situata aktuale e redaktorëve kosovarë është krahasuar me atë të paraluftës në sistemin njëpartiak, me vëmendje te veçantë në periudhën kalimtare 1989–99, kur pas heqjes së kundërligjshme të autonomisë së saj, Kosova u vendos nën administrimin e drejtpërdrejtë të dhunshëm policor të Serbisë.

1 Ejupi & Abazi, *Liria e shprehjes dhe e ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë - Analizë krahasimore e kornizës ligjore*, 2016. Në: http://www.indep.info/documents/19022_Liria%20e%20shprehjes%20dhe%20ushtrimit%20e%20profesionit%20e%20gazetarise%20one%20Kosove,%20analize%20krahasuese.pdf. Vizituar më 4 maj 2016. Shih poashtu Koha Ditore, "Zbatimi i legjislacionit në fushën e lirisë së medieve, ende problematik," 4 maj 2016, f.2.

2 UBO Consulting, *Media Indicators 2015: A thorough study from a journalists' point of view on Kosovo's media freedom and conditions*, f. 12. Commissioned by Kosovo Glocal - Kosovo 2.0, ÇOHU and Kosovo Press Council. 2015. Në: <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Media-Indicators-2015.pdf>. Vizituar 15 mars 2016.



INTEGRITETI
I MEDIAS KA
RËNDËSI

Ky hulumtim është realizuar në dy pjesë. Janë zhvilluar anketime dhe intervista me kryeredaktorë kryesisht të mediave të mëdha.

Anketa me 20 pyetje mbi çështje të rëndësishme të situatës së mediave dhe redaktorëve të Kosovës janë dërguar në nja 60 adresa. Duke qenë se reagimi i redaktorëve në anketë ishte shumë i ultë, u bënë përpjekje të përsëritura me emaile dhe telefonata që ata të nxiten që të përgjigjen në pyetjet mbi situatën e tyre. Mirëpo vetëm pas takimeve individuale me kryeredaktorët e mediave kryesore nja 10 prej tyre janë përgjigjur në pyetjet e anketës. Për ta kompensuar këtë mostër relativisht të vogël, u zhvilluan intervista me 10 redaktorë aktualë apo ish-redaktorë të mediave kosovare.

Ky hezitim relativisht i lartë i respondentëve të kontaktuar pët të marrë pjesë në këtë anketë nuk mund të shpjegohet vetëm me axhendën zakonisht të ngarkuar të redaktorëve. Sepse siç kanë pranuar edhe disa prej respondentëve në intervistat e tyre, disa nga pyetjet e hulumtimit tonë me sa duket për shumicën e redaktorëve kosovarë kanë qenë tepër delikate për t'u diskutuar. Vetë ky fakt flet mjaft për situatën aktuale të redaktorëve kosovarë.

1 SITUATA LIGJORE E REDAKTORËVE

Legjislacioni kosovar i medias është relativisht i ri dhe në përgjithësi në përputhje me standardet europiane/ndërkombëtare.³ Para së gjithash, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita që garantojnë lirinë e shprehjes (Neni 40) dhe lirinë e medias (Neni 42).⁴

Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media që u formua nga UNMIK-u pas luftës së vitit 1999 si rregullator i përkohshëm merrej si me media elektronike ashtu edhe me ato të shkruara.⁵ Më vonë, gjatë procesit të bartjes së përgjegjësive për zhvillimin e mediave tek autoritetet kosovare, më 2005 do të promovohet vetërregullimi i mediave të shkruara përmes Këshillit të Mediave

**GAZETARËT DHE
REDAKTORËT KOSOVARË
PAGUHEN DOBËT
MADJE EDHE SËPAS
STANDARDEVE TË
KOSOVËS, NDËRSA
SHUMÏCA E TYRE
PUNOJNË PA KONTRATA
PUNE.**

3 Shih Brogi et al., *Freedom of Media in Western Balkans*, European Parliament, p. 32. Commissioned by the Subcommittee on Human Rights of the European Parliament. 2014. Në: http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/534982/EXPO_STU%282014%29534982_EN.pdf. Vizituar 18 mars 2016. Shih poashtu INDEP, *The State of the Media in Kosovo 2015*, 2015. Në: http://www.indep.info/documents/71012_INDEP%20-%20The%20State%20of%20the%20Media%20in%20Kosovo%202015.pdf. Vizituar 18 mars 2016.

4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

5 UNMIK, Regulation No. 2000/36, On the Licensing and Regulation of Broadcast Media in Kosovo, 17 June 2000. Në: <http://www.unmikonline.org/regulations/2000/reg36-00.htm>. Vizituar 5 mars 2016.

të Shkruara të Kosovës (KMSHK).⁶ Në anën tjetër, mediat elektronike rregullohen nga *Ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media*.⁷ Përpos kësaj, transmetuesi publik rregullohet nga Ligji mbi Radiotelevizionin e Kosovës (RTK).⁸ Vetërregullimi i mediave të shkruara bazohet në Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës.⁹ Ekziston poashtu Kodi i Sjelljes për Shërbimet e Mediave Audiovizuale në Kosovë.¹⁰

Legjislacioni kosovar i medias u sfidua seriozisht në vitin 2012 nga kodi i ri penal, i cili afirmonte kriminalizimin e shpifjes (Neni 37) dhe obligonte gazetarët dhe redaktorët të zbulojnë burimet e tyre nëse ju kërkohet nga drejtësia (Neni 38).¹¹ Falë një fushate këmbëngulëse dhe mirë të organizuar avokimi nga komuniteti kosovar i medias dhe mbështetjes nga organizatat ndërkombëtare të mediave, këto nene në fund u hoqën në tërësi.¹² Për më tepër, si rezultat i momentumit të krijuar nga kjo fushatë, në vitin 2013 Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin mbi Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë.¹³ Ligji mbi Qasjen në Dokumente Publike është lavdëruar si për cilësinë e tij ashtu edhe për rëndësinë e tij të madhe për punën e gazetarëve dhe redaktorëve të Kosovës.¹⁴

-
- 6 Shih OSCE, *OSCE Mission welcomes formation of Kosovo Press Council*, 10 August 2005. Në: <http://www.osce.org/kosovo/46679>. Vizituar 5 mars 2016. Shih poashtu webfaqën e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Në: <http://presscouncil-ks.org/>. Vizituar 5 mars 2016.
- 7 Ligji Nr.04/L-044, Mbi Komisionin e Pavarur të Mediave, 2 mars 2012. Në: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1335250709.2603.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.
- 8 Ligji Nr. 04/L-046, Mbi Radiotelevizionin e Kosovës, 29 mars 2012. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Radio%20Television%20of%20Kosova.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.
- 9 KMSHK, *Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës*. Në: http://www.presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf. Vizituar 5 mars 2016.
- 10 KPM, *Kodi i sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale në Republikën e Kosovës*, 2010. Në: <http://www.kpm-ks.org/materiale/dokument/1440595669.437.doc>. Vizituar 5 mars 2016.
- 11 *Kodi Nr. 04/L-082, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës*, 2012. Në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.
- 12 Shih UNDP, *Action Paper on Association of Professional Journalists in Kosovo: Freedom of Expression in the Media and the Role of the Association of Professional Journalists of Kosovo*, 29 March 2012. Në: http://www.apjk.org/repository/docs/Action_Papers%20Ang.pdf. Vizituar 6 mars 2016. Shih poashtu Balkanmedia, *Media freedom in Kosovo*. Në: <http://www.kas.de/wf/en/71.13602/>. Vizituar 6 mars 2016. Shih gjithashtu European Fund for the Balkans, *Media freedom and integrity in the Western Balkans: Recent developments*, Paper series, March 2015. Në: <http://balkanfund.org/wp-content/uploads/2015/03/Media-freedom-and-integrity-in-the-Western-Balkans-Recent-developments.pdf>. Vizituar 5 mars 2016. Shih poashtu Human Rights Watch, "Kosovo: New Law Puts Media Freedom at Risk," 27 June 2012. Në: <https://www.hrw.org/news/2012/06/27/kosovo-new-law-puts-media-freedom-risk>. Vizituar 5 mars 2016.
- 13 Ligji Nr. 04/L-137, Mbi Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, 2013. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20protection%20of%20the%20journalism%20sources.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.
- 14 Ligji Nr.03/L-215, Mbi Qasjen në Dokumente Publike, 2010. Në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2724>. Vizituar 5 mars 2016.
-

Legjislacioni aktual i medias nuk përmban dispozita specifike mbi përgjegjësitë dhe të drejtat e redaktorëve të mediave. Mirëpo, Ligji i KPM-së ka dispozita që rregullojnë politikën e transmetimit të KPM-së. Neni 9 saktëson se “politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare mbi transmetimin dhe të drejtat e njeriut, legjislacionin përkatës të BE-së e në veçanti me Direktivën e Komisionit Europian AVMS duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes.”¹⁵ Në të njëjtën mënyrë, Neni 18 i Ligjit të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) përmban dispozita të detajuara mbi politikën editoriale dhe përmbajtjen e programit të transmetuesit publik. Paragrafi 8 i këtij neni thekson se “politika editoriale e RTK-së duhet të jetë e pavarur, korrekte, profesionale, objektive, e balansuar dhe e paanshme.”¹⁶ Ky ligj poashtu përmban dispozita mbi kushtet e emërimit dhe shkarkimit të menaxhmentit të RTK-së (Neni 31).¹⁷ Neni 35, i cili rregullon emërimin e menaxhmentit të RTK-së, poashtu përmban dispozita që specifikojnë procedurat e emërimit dhe shkarkimit të kryeredaktorit dhe redaktorëve tjerë të lartë të transmetuesit publik.¹⁸ Paragrafi 5 i këtij neni parasheh se “secili kryeredaktor i RTK-së zgjedhet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së në bazë të konkursit publik dhe sipas rekomandimit të drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtorit të radios.”¹⁹ Paragrafi i njëjtë i Nenit 35 specifikon që “kryeredaktori të mos jetë tri (3) vitet e fundit në organet e larta udhëheqëse politike.”²⁰ Përpos kësaj, paragrafi 6 i këtij neni specifikon se “kryeredaktori i RTK-së shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Statut.”²¹

Si Ligji i KPM-së ashtu edhe ai i RTK-së garantojnë të drejtën e reagimit. Neni 35 i Ligjit të KPM-së garanton të drejtën e korigjimit të informacionit të transmetuar, ose të reagimit ndaj informacionit të transmetuar.²² Në këtë frymë, Neni 10 i Ligjit të RTK-së specifikon se “RTK në përputhje me ligjin dhe

15 Ligji Nr.04/L-044, Mbi Komisionin e Pavarur të Mediave, 2 mars 2012. Në: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1335250709.2603.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

16 Ligji Nr. 04/L-046, Mbi Radiotelevizionin e Kosovës, 29 mars 2012. Në: <http://www.kuven-dikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Radio%20Television%20of%20Kosova.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

17 Ibid.

18 Ibid.

19 Ibid.

20 Ibid.

21 Ibid.

22 Ligji Nr.04/L-044, Mbi Komisionin e Pavarur të Mediave, 2 mars 2012. Në: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1335250709.2603.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

**LEGJISLACIONI AKTUAL
I MEDIAS NUK PËRMBAN
DISPOZITA SPECIFIKE
MBI PËRGJEGJËSITË
DHE TË DREJTAT E
REDAKTORËVE TË
MEDIAVE.
NENI 35, I CILI
RREGULLON EMËRIMIN
E MENAXHMENTIT
TË RTK-SË, POASHTU
PËRMBAN DISPOZITA
QË SPECIFIKOJNË
PROCEDURAT E
EMËRIMIT DHE
SHKARKIMIT TË
KRYEREDAKTORIT
DHE REDAKTORËVE
TJERË TË LARTË TË
TRANSMETUESIT
PUBLIK.**

kodin e sjelljes për media elektronike, secilit person fizik dhe juridik i ofron të drejtën për reagim dhe qartësim.”²³

Pronarët dhe redaktorët e mediave kosovare ju referohen ligjeve të tjera kur kanë të bëjnë me rregullimin e përgjegjësive dhe të drejtave të tyre reciproke; konkretisht, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet redaktorëve dhe organizatave të tyre mediale janë të bazuara në Ligjin e Punës.²⁴

Mirëpo, problem kryesor në Kosovë nuk është vakumi ligjor, por zbatimi i dobët i ligjeve egzistuese.²⁵ Për shembull, një përqindje e rëndësishme e gazetarëve kosovarë nuk kanë kontrata të punësimit. Sipas Zekirja Shabanit, përfaqësues i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, rreth 30 për qind të antarëve të kësaj shoqate punojnë pa kontrata të punës.²⁶ Kjo përqindje, sipas Shabanit, mund të jetë edhe më e lartë nëse kemi parasysh se jo të gjithë gazetarët janë të gatshëm të tregojnë se punojnë pa kontrata.²⁷ Arsyeja e këtij ngurrimi me sa duket ka të bëjë me frikën e një pjese të gazetarëve dhe redaktorëve se nëse flasin mbi këtë çështje do të humbin punën. Vërtetë, sipas Indikatorëve të Mediave 2015, vetëm 33 përqind e 175 gazetarëve që morrën pjesë në këtë hulumtim kanë kontrata punësimi; 45 përqind e tyre kanë deklaruar se nuk kanë kontrata të rregullta të punësimit, kurse 22 përqind se nuk kanë informatë për këtë.²⁸ Këto të dhëna me sa duket reflektojnë kryesisht situatën e mediave të vogla, atyre lokale dhe posaçërisht të portaleve online, meqë të gjithë redaktorët e transmetuesve kryesorë dhe të gazetave ditore që kanë marrë pjesë në hulumtimin tonë kanë kontrata pune. Mirëpo disa prej tyre kanë raportuar raste të mëhershme kur kanë punuar për media të vogla pa kontrata.

Redaktorët e *RTK-së* kanë kontrata të përherëshme të punësimit. Në anën tjetër, mediat private me sa duket parapëlqejnë kontrata njëvjeçare madje edhe për kyeredaktorët e tyre. Problem tjetër është cilësia e këtyre kontratave. Për

23 Ligji Nr. 04/L-046, Mbi Radiotelevizionin e Kosovës, 29 mars 2012. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Radio%20Television%20of%20Kosova.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

24 Ligji Nr.03/L-212, Ligji i Punës, 2010. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

25 OSCE Mission in Kosovo, *Freedom of Media and Safety of Journalists in Kosovo*, June 2014, p. 8. Në: <http://www.osce.org/kosovo/122390?download=true>. Vizituar 12 mars 2016. Shih poashtu Ejupi & Abazi, *Liria e shprehjes dhe e ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë - Analizë krahasimore e kornizës ligjore*, 2016. Në: http://www.indep.info/documents/19022_Liria%20e%20shprehjes%20dhe%20ushtrimit%20e%20profesionit%20e%20gazetarise%20ne%20Kosove,%20analize%20krahasuese.pdf. Vizituar 4 maj 2016. Shih poashtu Koha Ditore, “Zbatimi i legjislacionit në fushën e lirisë së medieve, ende problematik,” 4 maj 2016, f. 2.

26 Intervistë me Zekirja Shabanin, kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe ish redaktor në të përditshmen *Tribuna*, Prishtinë, 5 prill 2016.

27 Ibid.

28 UBO Consulting, *Media Indicators 2015: A thorough study from a journalists' point of view on Kosovo's media freedom and conditions*. Commissioned by Kosovo Glocal - Kosovo 2.0, ÇOHU and Kosovo Press Council. 2015. Në: <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Media-Indicators-2015.pdf>. Vizituar 15 mars 2016.

REDAKTORËT E RTK-SË KANË KONTRATA TË PËRHERSHME TË PUNËSIMIT. NË ANËN TJETËR, MEDIAT PRIVATE ME SA DUKET PARAPËLQEJNË KONTRATA NJËVJEÇARE MADJE EDHE PËR KYEREDAKTORËT E TYRE. KONTRATAT AKTUALE NË RTV 21 PËRMBAJNË NJË NEN QË I OBLIGON GAZETARËT DHE REDAKTORËT QË T'I PAGUAJNË KËTIJ MEDIUMI 6,000 EURO NËSE ËKUN PREJ TIJ PËR TË PUNUAR PËR NDNJË TRANSMETUES TJETËR.

shembull, kontratat aktuale në RTV 21 përmbajnë një nen që i obligon gazetarët dhe redaktorët që t'i paguajnë këtij mediumi 6,000 euro nëse ikun prej tij për të punuar për ndonjë transmetues tjetër.²⁹

Zbatimi i dobët i ligjeve poashtu me sa duket është arsye kryesore, ose të paktën pjesë e problemit serioz që ka të bëjë me kushtet e punës dhe sigurinë e gazetarëve. Gjatë viti 2015, për shembull, ka pasur 27 raste të kërcënimeve kundër gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë.³⁰ Shumica e këtyre rasteve kanë qenë kanosje serioze ndaj jetës.³¹ Numri i kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë në të vërtetë mund të jetë edhe më i madh, meqë jo të gjithë i raportojnë këto raste. Për shembull Arbana Xharra, kryeredaktore e të përditshmes *Zëri*, e ka ndërprerë paraqitjen e rasteve të shpeshta të kërcënimeve ndaj saj në Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK).³² Ajo nuk beson se ia vlen ta bëjë këtë më tutje, meqë është e pakënaqur me mungesë të reagimit nga ky asociacion i gazetarëve ndaj disa kërcënimeve të fundit kundës saj nga ana e ekstremistëve islamikë.³³

Policia e Kosovës pretendon se merret me të gjitha rastet e paraqitura të kërcënimeve dhe sulmeve kundër gazetarëve dhe redaktorëve.³⁴ Mirëpo, kur këto raste dërgohen te prokurorët dhe gjykatat përkatëse, ato humbin në grumbullin e rasteve të tjera të shumta që presin.³⁵ Gjykatat e Kosovës janë të stërngarkuara me raste që janë akumuluar ndër vite. Gjyqësia e Kosovës thjesht nuk ka kapacitete për t'i trajtuar brenda një kohe të arsyeshme rastet e shumta që presin për drejtësi. Përpos kësaj, Policia e Kosovës, prokurorët dhe gjykatësit nuk kanë trajnim adekuat për t'u marrë në mënyrë të duhur me rastet e mediave.³⁶

2 KUALIFIKIMET ARSIMORE TË REDAKTORËVE

Pas vitit 1999 ka pasur zhvillime të rëndësishme në arsimimin e gazetarëve dhe redaktorëve në Kosovë. Universiteti publik i Prishtinës dhe disa kolegje private kanë filluar të ofrojnë studime në gazetari. Më 2005 Instituti i Kosovës

29 Intervistë me Agim Binakun, redaktor përgjegjës i Departamentit të informacionit dhe sportit, RTV 21, Prishtinë, 6 prill 2016.

30 Intervistë me Zekirja Shabanin, kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe ish redaktor në të përditshmen *Tribuna*, Prishtinë, 5 prill 2016.

31 Ibid.

32 Intervistë me Arbana Xharrën, kryeredaktore, e përditshmja *Zëri*, Prishtinë, 1 prill 2016.

33 Ibid.

34 Xharra & Hamidi, "Balkan journalists under pressure," SEE Media Observatory, 29 January 2016. Në: <http://mediaobservatory.net/investigative-journalism/balkan-journalists-under-pressure>. Vizituar 12 mars 2016.

35 Ibid.

36 OSCE Mission in Kosovo, *Freedom of Media and Safety of Journalists in Kosovo*, June 2014. Në: <http://www.osce.org/kosovo/122390?download=true>. Vizituar 12 mars 2016.

POLICIA E KOSOVËS
PRETENDON SE MERRET
ME TË GJITHA RASTET
E PARAQITURA TË
KËRCËNIMEVE DHE
SULMEVE KUNDËR
GAZETARËVE DHE
REDAKTORËVE.
MIRËPO, KUR KËTO
RASTE DËRGOHEN TE
PROKURORËT DHE
GJYKATAT PËRKATËSE,
ATO HUMBËN NË
GRUMBULLËN E RASTEVE
TË TJERA TË SHUMTA QË
PRESIN.

për Gazetari dhe Komunikim (IKGK/KIJAC) filloi një program të studimeve master në gazetari dhe komunikim.

Përpos këtyre shkollave për arsimim formal të gazetarëve, gjatë kësaj periudhe të pasluftës ka pasur një numër të programeve të llojllojshme të trajnimit të organizuara për gazetarë dhe redaktorë nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, OJQ të mediave, donatorë dhe agjensione qeveritare që vepruan në Kosovë pas luftës. Pothuaj në të njejtën kohë me KIJAC-in u formua Instituti Kosovar i Medias, që ishte paraparë të ofronte *in-service* trajnime.

Një numer i gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë kanë pasur mundësi që të realizojnë vizita studimore në SHBA dhe vende europiane, ku kanë vizituar transmetues dhe gazeta të mirënjohura si dhe organizata mediale me qëllim të përmirësimit të njohurive dhe shkathtësive të tyre profesionale duke mësuar nga praktikat më të mira

A ka nevojë të përmendet se cilësia e arsimit formal dhe atij joformal që ju është ofruar gazetarëve dhe redaktorëve nga institucionet dhe organizatat e sipërpërmendura sillet nga improvizimet e shpejta deri te programet dhe trajnimet e kualitetit më të lartë. Për shembull, cilësia e programeve dhe mësimin në KIJAC, i cili qe themeluar me ndihmë të drejtpërdrejtë nga dy prindërit e tij akademikë, Gimlekollen School of Journalism (Norvegji) dhe Cardiff University (MB), të cilët poashtu siguronin edhe mësimdhënësit, nuk mund të krahasohet me programe studimi të improvizuara me nguti nga disa kolegje private kosovare. Sidoqoftë, mund të thuhet se kosovarët e rinj pas lufte kanë pasur mundësi më të mira për studime të gazetarisë dhe mediave. Përmes programeve formale dhe joformale të studimeve dhe trajnimeve, gazetarët dhe redaktorët kosovarë kanë qenë të ekspozuar ndaj informacionit mbi praktikat dhe standardet më të mira të profesionit dhe operimit të mediave.

Të dhjetë redaktorët që janë përgjigjur në anketën tone kanë përfunduar studimet bachellore. Katër prej tyre poashtu kanë master në studime të medias dhe gazetarisë. Prej atyre që deri më tash kanë përfunduar vetëm studimet bachelor, një ka diplomuar në gazetari, dy në ekonomi, një në shkencat politike dhe administratë publike, një tjetër në drejtësi, dhe i fundit ka diplomuar gjuhën angleze.

Kur është fjala për arsimimin joformal, të gjithë këta redaktorë kanë marrë pjesë në programe të llojllojshme trajnimi. Derisa katër nga këta redaktorë të lartë kanë marrë pjesë në kurse trajnimi që janë organizuar në Kosovë dhe vende tjera të Europës juglindore, të gjashtë kryeredaktorët e tjerë të mediave kryesore kosovare kanë pasur mundësi të bëjnë vizita studimi në SHBA dhe vende të tjera të Europës Perëndimore, ku kanë marrë pjesë në kurse intensive të trajnimit të organizuara nga universitetet, organizatat mediale, transmetuesit dhe mediat tjera të mirënjohura.

Të gjithë këta redaktorë flasin anglisht, përpos njerit që është përgjegjur se frengjishtja është gjuha e tij kryesore e huaj. Shumica prej tyre poashtu flasin Serbisht/Kroatisht/Boshnjakisht. Gjuhët e tjera që fliten nga disa prej tyre përfshijnë gjermanishten, spanjishten dhe italishten.

**NJË NUMER I
GAZETARËVE DHE
REDAKTORËVE
KOSOVARË KANË
PASUR MUNDËSI QË
TË REALIZOJNË VIZITA
STUDIMORE NË SHBA
DHE VENDE EUROPIANE,
KU KANË VIZITUAR
TRANSMETUES
DHE GAZETA TË
MIRËNJOHURA.**

Pra, mund të thuhet se redaktorët e mediave të medha kosovare që morrën pjesë në hulumtimin tone kanë arsimim formal adekuat apo të dobishëm dhe se janë trajnuar mire përmes arsimimit joformal për punët që bëjnë.

3 SITUATA EKONOMIKE E REDAKTORËVE

Gazetarët dhe redaktorët e mediave kosovare paguhen dobët për punën që bëjnë. Vetëm tre nga 10 redaktorët që kanë marrë pjesë në anketën tone janë përgjigjur se pagat e tyre mujore sillen nga 1,000 deri 1,500 euro. Një është përgjigjur se rroga e tij është 500 euro, kurse të tjerët kanë pranuar se pagat e tyre sillen nga 500 deri 1,000 euro në muaj. Nëse kemi parasysh se po flasim për kryeredaktorë, redaktorë përgjegjës të diskut dhe redaktorë tjerë të lartë të mediave kryesore kosovare, atëherë vetëm mund të mirret me mend se çfarë është situata financiare e redaktorëve dhe gazetarëve tjerë. Edhe më e keqe besohet të jetë situata e gazetarëve dhe redaktorëve që punojnë për media të vogla dhe ato online. Për shembull, një nga redaktorët ka pranuar se ai më herët ka punuar për gjashtë vjet si kryeredaktor i një portali të lajmeve, pa kontratë dhe për vetëm 250 euro në muaj. Sipas një tjetër ish-kryeredaktori, rroga e gazetarëve të rinj që punojnë për njerin prej TV kanaleve kryesore të Kosovës është vetëm 150 euro.³⁷ Besohet se shumica e gazetarëve që punojnë për media lokale dhe ato online nuk kanë kontrata pune.³⁸ Për këtë arsye pronarët e mediave ndonjëherë nuk ua paguajnë rrogat e tyre. Për shembull, në januar të vitit 2014 kryeredaktori dhe 90 përqind e gazetarëve dhe stafit tjetër të së përditshmës Bota Sot lëshuan punën në këtë gazetë për arsye se nuk ishin paguar për muaj me radhë.³⁹ Bajrush Morina, ish kryeredaktor i Bota Sot pranon se ai dhe gazetarët e tij kishin punuar pa kontrata. Tash ai dhe kolegët e tij po përpiqen që me ndihmën e gjyqit të marrin rrogat e tyre të papaguara për 13 muaj.⁴⁰

Vlen të theksohet se pothuaj të gjithë redaktorët që participuan në anketën tone apo u intervistuan për këtë hulumtim kanë deklaruar se rrogat e tyre janë burimi i vetëm i të ardhurave për ta. Vetëm një nga respondentët tonë ka përmendur se përpos punës së tij si redaktor, ai është i angazhuar edhe si ligjërues në një kolegji privat. Nëse kemi parasysh dukurinë e përhapur të pasigurisë në

37 Intervistë me Bajrush Morinën, ish kryeredaktor i së përditshmës *Bota Sot*, Prishtinë, 29 mars 2016.

38 UBO Consulting, *Media Indicators 2015: A thorough study from a journalists' point of view on Kosovo's media freedom and conditions*, p. 12. Commissioned by Kosovo Glocal - Kosovo 2.0, ÇOHU and Kosovo Press Council. 2015. Në: <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Media-Indicators-2015.pdf>. Vizituar 15 mars 2016.

39 Intervistë me Bajrush Morinën, ish kryeredaktor i së përditshmës *Bota Sot*, Prishtinë, 29 mars 2016.

40 Ibid.

**GAZETARËT DHE
REDAKTORËT E MEDIAVE
KOSOVARE PAGUHEN
DOBËT PËR PUNËN
QË BËJNË. VETËM TRE
NGA 10 REDAKTORËT
QË KANË MARRË PJESË
NË ANKETËN TONE
JANË PËRGJIGJUR SE
PAGAT E TYRE MUJORE
SILLEN NGA 1,000
DERI 1,500 EURO. NJË
NGA REDAKTORËT KA
PRANUAR SE AI MË
HERËT KA PUNUAR
PËR GJASHTË VJET SI
KRYEREDAKTOR I NJË
PORTALI TË LAJMEVE,
PA KONTRATË DHE PËR
VETËM 250 EURO NË
MUAJ.**

punë, faktin se shumica e gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë punojnë pa kontrata pune ose në rastin më të mirë me kontrata njëvjeçare,⁴¹ atëherë është e kuptueshme pse ata ngurojnë madje edhe që të flasin për këtë situatë. Prandaj është e qartë pse rastet e pakënaqësisë së hapur janë të rralla, dhe pse vetëm në RTK ku redaktorët kanë kontrata të përhershme të punës ata kanë pasur guxim të organizohen dhe të protestojnë hapur kundër ndikimit politik në transmetuesin publik.

4 SITUATA PROFESIONALE E REDAKTORËVE

Redaktorët e mediave kosovare nuk kanë ndonjë organizatë të tyre të veçantë. Mirëpo, ekzistojnë dy shoqata të gazetarëve kosovarë, Unioni i Gazetarëve Kosovarë (UGK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK). AGK me sa duket është më aktive dhe më e pranishme në publik. Katër nga 10 redaktorët që kanë marrë pjesë në hulumtimin tonë janë anëtarë të kësaj shoqate, ndërsa dy të tjerë janë anëtarë të asociacioneve ndërkombëtare të gazetarëve. AGK ka qenë goxha aktiv dhe i dukshëm gjatë dy-tri viteve të fundit. Zakonisht reagon me deklarata publike në mbrojtje të profesionit në rastet kur anëtarët e tij raportojnë presione, kërcënime ose sulme që lidhen me punën e tyre. Mirëpo, ka njerëz që nuk janë të kënaqur me AGK-në. Arbana Xharra, kryeredaktore e të përditshmës *Zëri*, ka shprehur zhgënjimin e saj me këtë asociacion, meqë sipas saj ka dështuar që të reagojë ndaj disa kërcënimeve të fundit të bëra kundër saj nga ekstremistët islamikë.⁴² Ndërkaq, sipas kryetarit të AGK-së, kjo shpjegohet me faktin se kjo shoqatë reagon vetëm kur anëtarët e saj paraqesin kërkesë formale për mbrojtje ose mbështetje.⁴³ Nuk ka një sindikatë që përfaqëson interes profesional të të gjithë gazetarëve të Kosovës. Mirëpo, ekzistojnë dy organizata sindikale që përfaqësojnë gazetarët dhe punëtorët tjerë të RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të RTK-së si dhe Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të RTK-së. Vitin që shkoi Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të RTK-së ka qenë bukur aktive në mbështetjen e 60 redaktorëve dhe gazetarëve që protestuan kundër ndërhyrjeve editoriale të menaxhmentit për raportim të favorshëm mbi veprimtaritë dhe zyrtarët e partisë në pushtet.

Sidoqoftë, redaktorët dhe gazetarët e RTK-së nuk janë të vetmit që kanë përvoja të presionit dhe ndërhyrjeve nga menaxhmenti dhe/ose pronarët si dhe individët dhe grupet e fuqishme jashtë mediave. Duke u përgjigjur në pyetjen tonë për atë se sa janë në gjendje të mbrojnë pavarësinë editoriale dhe integritetin profesional të gazetarëve të tyre, vetëm katër nga 10 redaktorët e mediave

41 Vetëm gazetarët dhe redaktorët që punojnë në shërbimin publik RTK kanë kontrata të përhershme pune.

42 Intervistë me Arbana Xharrën, kryeredaktore, e përditshmja *Zëri*, Prishtinë, 1 prill 2016.

43 Intervistë me Zekirja Shabanin, kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe ish redaktor në të përditshmën *Tribuna*, Prishtinë, 5 prill 2016.

të mëdha që participuan në anketën tonë kanë deklaruar se gëzojnë pavarësi të plotë editoriale dhe se mund t'i mbrojnë gazetarët e tyre nga presionet e pas-hmangshme; katër të tjerë janë përgjigjur në këtë pyetje me “deri diku”, një me “shumë pak”, kurse ai i fundit me “aspak.” Intervistat e thella me redaktorë vertetuan të dhënat nga kjo mostër modeste dhe zbuluan se situata e mediave kosovare dhe e redaktorëve të tyre lidhur me përpjekjet për ndikimin e politikave të tyre editoriale është madje edhe më serioze. Vetëm dy nga këta redaktorë dhe ish-redaktorë konfirmuan se ata kanë pasë përvojë të pavarësisë së plotë editoriale. Mirëpo, njëri prej këtyre kryeredaktorëve ka shpjeguar se, përderisa nga ana e pronarëve nuk ka pasë tendencë apo përpjekje për të ndikuar politikën e saj editoriale, forma të ndryshme të presionit, përfshirë madje edhe kërcënimet për jetë janë bërë përvojë e saj pothuaj e përditshme gjatë këtyre viteve që kur e ka marrë këtë përgjegjësi. Redaktorët dhe ish-redaktorët tjerë kanë zbuluar se kanë përjetuar ndërhyrje pothuaj të përditshme editoriale nga pronarët e mediave. Zekirja Shabani ka deklaruar se gjatë punës së tij të mëhershme si redaktor i të përditshmes *Tribuna* (2012-2014), ai ka përjetuar presione dhe ndërhyrje të përditshme editoriale nga ana e pronarit të kësaj gazete.⁴⁴ Sipas tij, përpjekjet e tij për të mbrojtur pavarësinë editoriale kishin përfunduar në konflikt të hapur, kur ai ishte sulmuar fizikisht nga pronari.⁴⁵ Ky incident ishte raportuar gjërësisht nga mediat kosovare.⁴⁶ Mirëpo, pronari i *Tribunës* kishte mohuar se një incident i tillë kishte ndodhur.⁴⁷

Forma të ngjashme të frikësimit dhe të përzierjes editoriale nga ana e pronarëve kanë provuar shpesh edhe dy ish-redaktorë të tjerë, të cilët kishin dhënë dorëheqje si protestë kundër situatës në mediat e tyre.

Një numër i vëzhguesve dhe hulumtuesve kanë vërejtur dhe identifikuar tendenca të ngjashme të ndikimit të politikave editoriale të mediave kosovare, qoftë nga menaxhmenti/pronarët ose nga individët dhe grupet e jashtme me pushtet politik apo financiar.⁴⁸

44 Ibid.

45 Ibid.

46 Për shembull, shih *Gazeta Express*, “Gazetari Zekirja Shabani sulmohet fizikisht nga pronari i gazetës ‘Tribuna,’” 8 dhjetor 2014. Në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/gazetari-zekirja-shabani-sulmohet-fizikisht-nga-pronari-i-i-gazetes-tribuna-65137/?archive=1>. Vizituar 15 mars 2016. Shih poashtu Bota Sot, “Gazetari Zekirja Shabani sulmohet fizikisht nga pronari i gazetës ‘Tribuna,’” 8 dhjetor 2014. Në: <http://botasot.info/lajme/348313/gazetari-zekirja-shabani-sulmohet-fizikisht-nga-pronari-i-gazetes-tribuna-quot/>. Vizituar 15 mars 2016.

47 Shih *Kosova Live*, “Gazetari Shabani thotë se është sulmuar fizikisht nga pronari Demiri, e ky e mohon këtë,” 8 dhjetor 2014. Në: <http://www.kosovalive360.com/gazetari-shabani-thote-se-eshte-sulmuar-fizikisht-nga-pronari-demiri-e-ky-e-mohon-kete.html>. Vizituar 18 prill 2016.

48 Gashi, “Kosovo”, in *Nations in Transit 2016*, 2016. Në: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2016/kosovo>. Vizituar 28 prill 2016. Shih poashtu Miftari, “Kosovo’s Media Closer to Sustainability,” 25 June 2015. Në: <http://themediaproject.org/article/kosovos-media-near-sustainability-despite-weaknesses?page=full>. Vizituar 15 mars 2016.

**NJËRI PREJ KËTYRE
KRYEREDAKTORËVE
KA SHPJEGUAR SE,
PËRDERISA NGA ANA
E PRONARËVE NUK KA
PASË TENDENCË APO
PËRPJEKJE PËR TË
NDIKUAR POLITIKËN E
SAJ EDITORIALE, FORMA
TË NDRYSHME TË
PRESIONIT, PËRFSHIRË
MADJE EDHE
KËRCËNIMET PËR JETË
JANË BËRË PËRVOJË
E SAJ POTHUAJ
E PËRDITSHME.
REDAKTORËT DHE ISH-
REDAKTORËT TJERË
KANË ZBULUAR SE
KANË PËRJETUAR
NDËRHYRJE POTHUAJ
TË PËRDITSHME
EDITORIALE NGA
PRONARËT E MEDIAVE.**

Konteksti politik dhe ndikimi i tij mbi media ka qenë kufizimi kryesor i zhvillimit të mediave në Kosovë pas vitit 1999. Vitet e para të pasluftës ofruan kushte relativisht të mira për zhvillim të mediave të lira. Ky mjedis inkurajues, së bashku me mbështetjen bujare të donatorëve të shumtë, nxitën një zhvillim të paparë të mediave kosovare. Më vonë, kur përgjegjësia për zhvillimin e mediave kaloi tek autoritetet kosovare, u shënuan prapakthime në disa sektorë kyç të skenës së medias. Para së gjithash, *RTK* që deri atëherë ishte një nga transmetuesit publik më të suksesshëm në Europën Juglindore, papritur nuk ishte më imun ndaj presionit politik nga qeveria dhe grupet tjera politike në Kosovë. Partitë në pushtet ia arritën që këmba- këmbës të infiltrojnë njerzit e tyre në Bordin e *RTK-së*, në menaxhment si dhe në mesin e stafit të lartë editorial. Procese të ngjashme janë shfaqur edhe në Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ky ndikim dhe presion politik mbi *RTK*-në u konfirmua sërish përmes anketimit dhe intervistave me redaktorët e këtij transmetuesi publik.

Fitakeqsisht, *RTK* nuk është mediumi i vetëm që vuan nga frikësimi dhe instrumentalizimi politik. Edhe mediat private janë ballafaquar me forma të ndryshme të presionit politik. Për shembull, rasti i sipërpërmendur i presionit të vazhdueshëm e të drejtpërdrejtë nga ana e pronarit të së përditshmes *Tribuna* mbi redaktorin e saj, ka qenë, sipas Shabanit, i motivuar politikisht. Në të vërtetë, sipas tij, pronari i kësaj gazete ishte përpjekur të promovonte politikë editoriale që do të siguronte raportim dashmirës ndaj Aleancës Kosova e Re.⁴⁹ Një numër i rasteve tjera të ndikimit evident politik në mediat e Kosovës janë identifikuar nga vëzhguesit dhe hulumtuesit e huaj dhe ata vendorë⁵⁰ Disa nga këto raste janë përmenduar apo përshkruar shkurtimisht në raportin tonë paraprak mbi pronësinë dhe financimin e mediave në Kosovë.⁵¹

49 Intervistë me Zekirja Shabanin, kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe ish redaktor në të përditshmën *Tribuna*, Prishtinë, 5 prill 2016.

50 Gashi, "Kosovo", in *Nations in Transit 2016*, 2016. Në: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2016/kosovo>. Vizituar 28 prill 2016. Shih poashtu OSCE, Mission in Kosovo, *Circulation and Politicization of the Print Media in Kosovo*, 2010. Në: <http://www.osce.org/kosovo/67790?download=true>. Vizituar 4 mars 2016.

51 Berisha, *Media ownership and finances in Kosovo: Legal vacuum and lack of transparency*, SEE Media Observatory, 2015. Në: http://mediaobservatory.net/sites/default/files/Media%20Ownership%20and%20Finances%20in%20Kosovo_o.pdf. Vizituar 3 mars 2016.

6.1

RASTI I RTK-SË: LUFTA PËR INTEGRITET TË MEDIAS NË KUSHTE DËSHPRUESE

Në komunitetin e mediave dhe në publik është mjaft i përhapur përceptimi se RTK tash e sa vite është shndërruar në një platformë mediale pro-qeveritare.⁵² Dhe kur po dukej se nuk kishte shpresë imediate për përmirësimin e situates në këtë transmetues, 12 redaktorë të RTK-së u bënë bashkë në fillim të vitit 2015 për të kundërshtuar ndikimin dhe instrumentalizimin politik të këtij shërbimi publik. Në vijim atyre ju bashkuan edhe 50 redaktorë dhe gazetarë të tjerë të RTK-së.⁵³ Fushata e tyre kundër instrumentalizimit politik të transmetuesit publik u mbështet poashtu edhe nga Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të RTK-së.⁵⁴ Ata protestuan kundër censurës nga ana e kryeredaktorit dhe zëvendësit të tij dhe arritën të zëvendësojnë këta dy redaktorë kryesorë të cilët po bënin trysni mbi kolegët e tyre për të bërë raportime pro-PDK-së. Ata poashtu arritën që të rikthejnë në punë dy redaktorë protestues që ishin pezulluar nga menaxhmenti. Rabisha Muhaxhiri, një nga 12 redaktorët që nisën protestën kundër presionit politik mbi RTK, është e vetëdijshme se këto janë arritje modes-te.⁵⁵ Ajo e ka të qartë se tendenca e ndikimit dhe instrumentalizimit politik të RTK-së vazhdon të jetë e pranishme. Mirëpo, sipas Muhaxhirit, kjo protestë nga ana e redaktorëve dhe gazetarëve të RTK-së poashtu ka pasur edhe rezultate të tjera. Ajo sqaron: *“Prej atëherë ka pasur më shumë debat në RTK. Poashtu, menaxhmenti i ka diskutuar emërimet e reja me redaktorë dhe gazetarë. Protesta poashtu ka ndikuar në rritjen e kualitetit të programit dhe profesionalizmit të gazetarëve.”*⁵⁶ Mirëpo, mbase arritja më e madhe e kësaj fushate është se ajo ka ndihmuar redaktorët dhe gazetarët që të kuptojnë se lufta për integritet të profesionit duhet të zhvillohet çdo ditë, në të gjitha rrethanat, madje edhe atëherë kur situata duket dëshpëruese. Ose, siç shprehet Muhaxhiri: *“Lufta jonë me menaxhmentin për mbrojtjen e profesionalizmit vazhdon. Ne punojmë dhe kundërshtojmë ndërhyrjet kurdo që ato shfaqen. Grupi ynë mbetet aktiv dhe deri diku ka ndikim në vendimet e menaxhmentit.”*⁵⁷

12 REDAKTORË TË RTK-SË U BËNË BASHKË NË FILLIM TË VITIT 2015 PËR TË KUNDËRSHTUAR NDIKIMIN DHE INSTRUMENTALIZIMIN POLITIK TË KËTIJ SHËRBIMI PUBLIK. NË VIJIM ATYRE JU BASHKUAN EDHE 50 REDAKTORË DHE GAZETARË TË TJERË TË RTK-SË.

52 UBO Consulting, *Media Indicators 2015: A thorough study from a journalist's point of view on Kosovo's media freedom and conditions*. Commissioned by Kosovo Glocal - Kosovo 2.0, ÇOHU and Kosovo Press Council. 2015. Në: <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Media-Indicators-2015.pdf>. Vizituar 15 mars 2016.

53 Koha Ditore, “Gjashtëdhjetë gazetarë e redaktorë të RTK-së kundër drejtorit,” 13 prill 2015, f.5.

54 Koha Ditore, “Sindikalistët e RTK-së paralajmërojnë radikalizim të protestës,” 2 prill 2015, f.7.

55 Intervistë me Rabisha Muhaxhirin, kryeredaktore e programit për komunitete dhe redaktore e Departamentit të lajmeve, RTK 1, Prishtinë, 6 prill 2016.

56 Ibid.

57 Ibid.

Halil Matoshi është gazetar dhe shkrimtar i mirënjohur, i cili për shumë vite ka shkruar pa ngurim për temat më të ndjeshme të shoqërisë kosovare të pasluftës. Në vitin 2012 ai madje është sulmuar dhe rrahur nga tre persona të panjohur në Prishtinë.⁵⁸ Karriera e tij e gjatë prej gazetari dhe redaktori është e mbushur me momente që paraqesin shembuj ilustrativë të problemeve të ndryshme me të cilat janë ballafaquar mediat kosovare dhe redaktorët e tyre në periudhën e pasluftës.

Sipas tij, shumë shpejt pasi ishte emëruar kryeredaktor i javores *Zëri* në vitin 2000, drejtori/pronari i tij kishte filluar që t'ia tëhiqte vërejtjen se ishte tepër kritik ndaj UNMIK-ut.⁵⁹ Në vitin 2003 drejtori kishte ndaluar botimin e një editoriali të Matoshit për arsye se ky kishte përdorur termin “neo-kolonializëm kulturor” në kritikën e tij ndaj administratorit të UNMIK-ut të Universitetit të Prishtinës. Matoshi kishte dhënë dorëheqje pas kësaj dhe më 2004 kishte kaluar te e përditshmja *Lajmi*, sërish si kryeredaktor.

Këtu ai do të ballafaqohej me ndërhyrje edhe më të shumta nga pronari dhe poashtu nga individë dhe grupe të jashtme me pushtet. Dhe kur pronari ia kishte paraqitur një listë me nja 30 kompani që *Lajmi* nuk duhej ti kritikonte, Matoshi sërish kishte dhënë dorëheqje në vitin 2006 dhe kishte organizuar konferencë për media ku kishte shpjeguar se çka kishte ndodhur. Pasi punon për një kohë si redaktor te *Gazeta Express*, në vitin 2009 kalon te *Koha Ditore* (KD) si kolumnist dhe redaktor i shtojcës për kulturë. Këtu ai nuk kishte pasur kufizime për sa i përket kolumnës së tij nga ana e menaxhmentit/pronarët. Mirëpo, sipas Matoshit, pas publikimit të një vështrimi kritik mbi një publikim të Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës, më 2011,⁶⁰ ai ishte zëvendësuar nga pozita e redaktorit të shtojcës për kulturë. Gazeta e kishte ftuar Matoshin që të vazhdonte me kolumnën e tij, gjë të cilën ky e sheh si gjest të kompromisit në këtë ndodhi.⁶¹

58 Reporters without Borders, “Knife attack on leading independent journalist in Pristina,” 11 July 2012. Në: <https://rsf.org/en/news/knife-attack-leading-independent-journalist-pristina>. Vizituar 15 mars 2016.

59 Intervistë me Halil Matoshin, ish kryeredaktor i javores *Zëri* dhe i të përditshmes *Lajmi*, ish redaktor te *Gazeta Express* dhe *Koha Ditore*, Prishtinë, 30 mars 2016.

60 Lajmeshqip.com, “Matoshi: Monografia Kosova, me morra,” 24 shtator 2011. Në: <http://www.lajmeshqip.com/kultura/matoshi-monografia-kosova-me-morra>. Vizituar 15 mars 2016.

61 Intervistë me Halil Matoshin, ish kryeredaktor i javores *Zëri* dhe i të përditshmes *Lajmi*, ish redaktor te *Gazeta Express* dhe *Koha Ditore*, Prishtinë, 30 mars 2016.

ZËRI – ÇMIMI I LARTË I PAVARËSISË EDITORIALE

Kryeredaktorja e së përditshmes *Zëri* Arbana Xharra është bërë ikonë e kësaj gazete. Ajo njihet për shkrimet e saj mbi tema të ndjeshme që kanë të bëjnë me korrupsionin, politikën, islamin e politizuar, etj. Artikujt e saj zakonisht mbështeten në gazetari hulumtuese.

Sipas Xharrës, *Zëri* gëzon pavarësi të plotë editoriale pa kurrëfarë ndërhyrjesh nga pronarët e tij.⁶² Mirëpo, ajo ka përjetuar forma të ndryshme të frikësimit dhe kërcënimeve nga individë dhe grupe të pakënaqura me shkrimet e saj. Më të shpeshta dhe më agresive janë kërcënimet që ajo merr nga ekstremistët islamikë kurdoherë që boton ndonjë gjë që ka të bëjë me islamin e politizuar. Ajo poashtu ka pasur padi ligjore që janë nisur kundër saj nga kompanitë që ishin irituar nga artikujt e Xharrës. Një nga këto ka ngritur padi kundër Xharrës duke kërkuar 700,000 euro kompenzim. Megjithatë, mënyra më e shpeshtë e reagimit të kompanive të pakënaqura me raportimin e *Zërit* është ndërprerja e bashkëpunimit dhe tërheqja e reklamimit në këtë të përditshme. Xharra është shumë e vetëdijshme për këtë. Sipas saj, *Zëri* është duke paguar çmim shumë të lartë për pavarësinë e tij editoriale.⁶³

7

PËRFUNDIME

Kosova ka pasur një zhvillim dramatik dhe të paprecedent të skenës së mediave pas vitit 1999. Liria e pasluftës si dhe mbështetja bujare nga donatorë të shumtë ishin nxitje e fuqishme për zhvillim të shpejtë të mediave. Brenda një viti pas përfundimit të luftës u nisën mbi 100 media të ndryshme.⁶⁴ Të gjitha këto ishin media të reja që po fillonin nga hiri, meqë dekada e mëparshme e sundimit të drejtpërdrejtë kolonial të Serbisë mbi Kosovën, që ishte karakterizuar nga represioni sistematik e brutal policor mbi gazetarët kosovarë, kishte përfunduar me mbylljen e të gjitha mediave në gjuhën shqipe në fillim të vitit 1999.⁶⁵

Këto zhvillime dramatike në skenën mediale të Kosovës do të reflektoheshin drejtpërsëdrejti në situatën e gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë. Në këto rrethana të pasluftës, gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë ju ofruan mundësi të reja të arsimimit formal dhe joformal në punë. Përmes kurseve të shumta të trajnimit të organizuara nga organizata ndërkombëtare si dhe vizitave studimore pranë mediave perëndimore, gazetarët dhe redaktorët kosovarë u ekspozuan ndaj informacionit mbi standardet ndërkombëtare të gazetarisë

62 Intervistë me Arbana Xharrën, kryeredaktore, e përditshmja *Zëri*, Prishtinë, 1 prill 2016.

63 Ibid.

64 Berisha, "Kosovo/a", in *Media Ownership and its Impact on Media Independence and Pluralism*, 2004, p.220.

65 Ibid.

MËNYRA MË E SHPESHTË E REAGIMIT TË KOMPANIVE TË PAKËNAQURA ME RAPORTIMIN E ZËRIT ËSHTË NDËRPRERJA E BASHKËPUNIMIT DHE TËRHEQJA E REKLAMIMIT NË KËTË TË PËRDITSHME. XHARRA ËSHTË SHUMË E VETËDIJSHME PËR KËTË. SIPAS SAJ, ZËRI ËSHTË DUKE PAGUAR ÇMIM SHUMË TË LARTË PËR PAVARËSINË E TIJ EDITORIALE.

profesionale dhe praktikave më të mira të operimit të mediave. Dhe më e rëndësishme, Kosova miratoi legjislacion të ri të mediave që është relativisht i mirë dhe në përgjithësi në përputhje me standardet europiane/ndërkombëtare të zhvillimit të mediave të lira. Sidoqoftë, zbatimi i dobët i këtyre ligjeve mbetet sfida serioze për mediat dhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. Për pasojë, gazetarët dhe redaktorët kosovarë nuk janë të mbrojtur sa duhet nga institucionet e zbatimit të ligjit prej formave të ndryshme të frikësimit dhe kërcënimeve që kanë të bëjnë me punën e tyre. Me sa duket shumica e gazetarëve dhe redaktorëve në Kosovë punojnë pa kontrata punësimi. Përpos kësaj, pagat e gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë janë larg nivelit adekuat për punën që ata bëjnë. Vetëm disa nga kryeredaktorët e mediave të mëdha marrin diçka më shumë se 1,000 euro në muaj. Pagat e redaktorëve tjerë të lartë të mediave të mëdha janë dukshëm më të vogla, derisa shumica e kryeredaktorëve të mediave lokale dhe atyre online punojnë për vetëm disa qindra euro në muaj. Një redaktor ka pranuar se deri vonë ai për gjashtë vjet ka punuar si kryeredaktor i një portali të lajmeve për vetëm 250 euro në muaj, dhe atë pa kontratë pune.

Në përgjithësi, mund të thuhet se situata e redaktorëve në Kosovë pas luftës së vitit 1999 është përmirësuar në disa aspekte kyçe krahasuar me gjendjen e mediave të kontrolluara nga shteti në periudhën e gjatë të paraluftës në sistemin njëpartiak. Kjo posaqërisht vlen nëse situata e mediave e pasluftës krahasohet me atë të periudhës kalimtare gjatë dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit 20, kur gazetarët dhe mediat kosovare ju nënshtroheshin represionit sistematik dhe mbylljes nga ana e policisë serbe. Mbi të gjitha, mund të përmenden arritjet e legjislacionit të ri që siguron parakushte ligjore për liri të shprehjes dhe zhvillim të lire të mediave.

Mirëpo, në disa aspekte tjera situata e redaktorëve dhe gazetarëve ka shënuar prapakhthime. Për shembull, redaktorët dhe gazetarët në Kosovë kanë pasur situatë shumë më të mirë ekonomike në sistemin njëpartiak, kur ata kishin paga të mira dhe kontrata të përhershme punësimi, ndërsa profesioni i tyre ishte shumë më i respektuar nga shoqëria.

8 REKOMANDIME

1. Ekziston nevoja për më shumë hulumtime bazuar në mostër më të madhe të gazetarëve dhe redaktorëve për aspekte të ndryshme të situatës së tyre. AGK duhet të merr iniciativën lidhur me këtë.
2. Shoqatat e gazetarëve duhet të organizojnë debata të informuar, të orientuar në gjetjen e zgjidhjeve për situatën e pakënaqshme të gazetarëve dhe redaktorëve kosovarë.

GAZETARËT DHE REDAKTORËT KOSOVARË NUK JANË TË MBROJTUR SA DUHET NGA INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË LIGJIT PREJ FORMAVE TË NDRYSHME TË FRIKËSIMIT DHE KËRCËNIMEVE QË KANË TË BËJNË ME PUNËN E TYRE. REDAKTORËT DHE GAZETARËT NË KOSOVË KANË PASUR SITUATË SHUMË MË TË MIRË EKONOMIKE NË SISTEMIN NJËPARTIAK, KUR ATA KISHIN PAGA TË MIRA DHE KONTRATA TË PËRHERSHME PUNËSIMI, NDËRSA PROFESIONI I TYRE ISHTE SHUMË MË I RESPEKTUAR NGA SHOQËRIA.

3. Shoqatat e gazetarëve duhet të organizojnë fushata avokimi për zbatim më të mire të legjislacionit që prekë operimin e mediave dhe situatën e gazetarëve dhe redaktorëve.
4. Inspektorati i Punës duhet t'i kushtojë shumë më tepër vëmendje zbatimit të Ligjit të Punës në organizatat e medias në Kosovë.
5. Shoqatat e gazetarëve duhet të organizojnë fushata avokimi dhe të senzibilizimit të publikut për të tërhequr vëmendjen mbi tendencën aktuale të ndikimit politik dhe ekonomik mbi media, me qëllim të rritjes së presionit të publikut ndaj atyre që janë të përfshirë në aktivitete të këtilla.
6. Asociacionet e mediave dhe shoqëria civile duhet të mbështesin ata redaktorë dhe gazetarë të RTK-së që po luftojnë për mbrojtjen e integritetit të tyre profesional nga presioni politik dhe ekonomik.
7. Komisioni Europian duhet që në dialogun me Qeverinë e Kosovës t'ju kushtojë më shumë vëmendje çështjeve të ndikimit politik dhe ekonomik mbi media, si dhe problemit të zbatimit joadekuat të ligjeve që prekin veprimtarinë e mediave dhe situatën e gazetarëve dhe redaktorëve në Kosovë.

BIBLIOGRAFIA

- Balkanmedia, *Media freedom in Kosovo*.
Në: <http://www.kas.de/wf/en/71.13602/>.
Vizituar 6 mars 2016.
- Berisha, I., "Kosovo/a", in *Media Ownership and its Impact on Media Independence and Pluralism*, ed. B. Petković, Peace Institute, Ljubljana, 2004.
- Berisha, I., *Media ownership and finances in Kosovo: Legal vacuum and lack of transparency*, SEE Media Observatory, Peace Institute, Ljubljana, 2015. Në: http://mediaobservatory.net/sites/default/files/Media%20Ownership%20and%20Finances%20in%20Kosovo_o.pdf.
Vizituar 3 mars 2016.
- Bota Sot, "Gazetari Zekirja Shabani sulmohet fizikisht nga pronari i gazetës "Tribuna", 8 December 2014. Në: <http://botasot.info/lajme/348313/gazetari-zekirja-shabani-sulmohet-fizikisht-n-ga-pronari-i-gazetes-tribuna-quot/>.
Vizituar 15 mars 2016.
- Brogi et al., *Freedom of Media in the Western Balkans*, Commissioned by the Subcommittee on Human Rights of the European Parliament (DROI), 2014.
Në: http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2014/534982/EXPO_STU%282014%29534982_EN.pdf.
Vizituar 18 mars 2016.
- Ejupi, B. & Abazi, D., *Liria e shprehjes dhe e ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë - Analizë krahasimore e kornizës ligjore*, INDEP, Prishtinë, 2016. Në: http://www.indep.info/documents/19022_Liria%20e%20shprehjes%20dhe%20ushtrimit%20e%20profesionit%20e%20gazetarise%20e%20Kosove,%20analize%20krahasuese.pdf.
Vizituar 4 maj 2016.
- European Fund for the Balkans, *Media freedom and integrity in the Western Balkans: Recent developments*, Paper series, March 2015. Në: <http://balkanfund.org/wp-content/uploads/2015/03/Media-freedom-and-integrity-in-the-Western-Balkans-Recent-developments.pdf>.
Vizituar 5 mars 2016.

- Gashi, K., "Kosovo", in *Nations in Transit 2016*, Human Rights Watch, 2016. Në: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2016/kosovo>. Vizituar 28 prill 2016.
- Gazeta Express, "Gazetari Zekirja Shabani sulmohet fizikisht nga pronari i gazetës "Tribuna," 8 dhjetor 2014. Në: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/gazetari-zekirja-shabani-sulmohet-fizikash-nga-pronari-i-gazetes-tribuna-65137/?archive=1>. Vizituar 15 mars 2016.
- Human Rights Watch, "Kosovo: New Law Puts Media Freedom at Risk," 27 June 2012. Në: <https://www.hrw.org/news/2012/06/27/kosovo-new-law-puts-media-freedom-risk>. Vizituar 5 mars 2016.
- Institute for Development Policy, *The State of the Media in Kosovo 2015*, 2015. Në: http://www.indep.info/documents/71012_INDEP%20-%20The%20State%20of%20the%20Media%20in%20Kosovo%202015.pdf. Vizituar 18 mars 2016.
- Koha Ditore, "Sindikalistët e RTK-së paralajmërojnë radikalizim të protestës," 2 prill 2015, f.7.
- Koha Ditore, "Gjashtëdhjetë gazetarë e redaktorë të RTK-së kundër drejtorit," 13 prill 2015, f.5.
- Koha Ditore, "Zbatimi i legjislacionit në fushën e lirisë së medieve, ende problematik," 4 maj 2016, f. 2.
- Kosova Live, "Gazetari Shabani thotë se është sulmuar fizikisht nga pronari Demiri, e ky e mohon këtë," 8 dhjetor 2014. Në: <http://www.kosovalive360.com/gazetari-shabani-thote-se-eshte-sulmuar-fizikisht-nga-pronari-demiri-e-ky-e-mohon-kete.html>. Vizituar 18 prill 2016.
- Lajmeshqip.com, "Matoshi: Monografia Kosova, me morra," 24 shtator 2011. Në: <http://www.lajmeshqip.com/kultura/matoshi-monografia-kosova-me-morra>. Vizituar 15 mars 2016.
- Miftari, N., "Kosovo's Media Closer to Sustainability," 25 June 2015. Në: <http://themediaproject.org/article/kosovo-media-near-sustainability-despite-weaknesses?page=full>. Vizituar 15 mars 2016.
- OSCE, *OSCE Mission welcomes formation of Kosovo Press Council*, 10 August 2005. Në: <http://www.osce.org/kosovo/46679>. Vizituar 5 mars 2016.
- OSCE Mission in Kosovo, *Circulation and Politicization of the Print Media in Kosovo*, 2010. Në: <http://www.osce.org/kosovo/67790?download=true>. Vizituar 4 mars 2016.
- OSCE Mission in Kosovo, *Freedom of Media and Safety of Journalists in Kosovo*, June 2014, p. 8. Në: <http://www.osce.org/kosovo/122390?download=true>. Vizituar 12 mars 2016.
- Petković, B. (ed.), *Media integrity matters: reclaiming public service values in media and journalism*, Peace Institute, Ljubljana, 2014.
- Reporters Without Borders, "Knife attack on leading independent journalist in Pristina," 11 July 2012. Në: <https://rsf.org/en/news/knife-attack-leading-independent-journalist-pristina>. Vizituar 15 mars 2016.
- UBO Consulting, *Media Indicators 2015: A thorough study from a journalist's point of view on Kosovo's media freedom and conditions*. Commissioned by Kosovo Glocal - Kosovo 2.0, ÇOHU and Kosovo Press Council. 2015. Në: <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/05/Media-Indicators-2015.pdf>. Vizituar 15 mars 2016.
- UNDP, *Action Paper on Association of Professional Journalists in Kosovo: Freedom of Expression in the Media and the Role of the Association of Professional Journalists of Kosovo*, UNDP and USAID, 29 March 2012. Në: http://www.apjk.org/repository/docs/Action_Papers%20Ang.pdf. Vizituar 6 mars 2016.

Xharra, A. and Hamidi, L., "Balkan journalists under pressure," SEE Media Observatory, 29 January 2016. Në: <http://>

mediaobservatory.net/investigative-journalism/balkan-journalists-under-pressure. Vizituar 12 mars 2016.

LIGJET DHE RREGULLORET DHE BURIMET TJERA TË NDËRLIDHURA

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Constitution%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

Kodi Nr. 04/L-082, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, 2012. Në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

Ligji Nr.03/L-215, Mbi Qasjen në Dokumente Publike, 2010. Në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2724>. Vizituar 5 mars 2016.

Ligji Nr.04/L-044, Mbi Komisionin e Pavarur të Mediave, 2 mars 2012. Në: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1335250709.2603.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

Ligji Nr.03/L-212, Ligji I Punës, 2010. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

Ligji Nr. 04/L-137, Mbi Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, 2013. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/>

[Law%20on%20the%20protection%20of%20the%20journalism%20sources.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20the%20protection%20of%20the%20journalism%20sources.pdf). Vizituar 5 mars 2016.

Ligji Nr. 04/L-046, Mbi Radiotelevizionin e Kosovës, 29 mars 2012. Në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20Radio%20Television%20of%20Kosova.pdf>. Vizituar 5 mars 2016.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), Kodi i sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale në Republikën e Kosovës, 2010. Në: <http://www.kpm-ks.org/materiale/dokument/1440595669.437.doc>. Vizituar 5 mars 2016.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës. Në: http://www.presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf. Vizituar 5 mars 2016.

UNMIK, Regulation No. 2000/36, On the Licensing and Regulation of Broadcast Media in Kosovo, 17 June 2000. Në: <http://www.unmikonline.org/regulations/2000/reg36-00.htm>. Vizituar 5 mars 2016.

LISTA E INTERVISTAVE

Ridvan Berisha, kryeredaktor, *RTK 3*, Prishtinë, 6 prill 2016.

Sanela Bilalović, kryeredaktore e programit të *RTK-së* në gjuhën boshnjake, Prishtinë, 5 prill 2016.

Agim Binaku, kryeredaktor i diskut, *RTV 21*, Prishtinë, 6 prill 2016.

Mimoza Koprani, kryeredaktore e diskut, *RTV*, Prishtinë, 30 mars 2016.

Halil Matoshi, ish kryeredaktor i javores *Zëri* dhe i të përditshmes *Lajmi*, ish redaktor te *Gazeta Express* dhe *Koha Ditore*, Prishtinë, 30 mars 2016.

Bajrush Morina, ish kryeredaktor i së përditshmes *Bota Sot*, Prishtinë, 29 mars 2016.

Rabisha Muhaxhiri, kryeredaktore e programit për komunitete dhe redaktore e Deptamentit të lajmeve, *RTK 1*, Prishtinë, 6 prill 2016.

Avni Jashari, kryeredaktor, portali i lajmeve *arbresh.info*, Prishtinë, 1 prill 2016.

Zekirja Shabani, kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe ish redaktor në të përditshmen *Tribuna*, Prishtinë, 5 prill 2016.

Arbana Xharra, kryeredaktore, e përditshmja *Zëri*, Prishtinë, 1 prill 2016.

AUTORI

ISUF BERISHA është PhD kandidat i filozofisë politike në Universitetin e Zagrebit, Kroaci. Ai ka punuar si gazetar (1982–1995), menaxher i zhvillimit të mediave (1996–2005), udhëheqës i rregullatorit të mediave (2006–2007) si dhe hulumtues i mediave e ligjerues (2005–2010) në Kosovë. Aktualisht ligjeron metoda kërkimore dhe sociologji ekonomike në Kolegjin Riinvest në Prishtinë, Kosovë. Berisha e ka realizuar këtë raport si hulumtues i angazhuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, organizatë partnere në SEE Media Observatory.



Ky raport është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Peace Institute dhe e autorit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Europian.

Ky raport është prodhuar në kuadër të projektit Observatori i Mediave i Europës Juglindore, <http://www.mediaobservatory.net>

ROLI I REDAKTORËVE NË MBROJTJEN
E INTEGRITETIT TË MEDIAVE
NË KOSOVË

LUFTA PËR INTEGRITET
PROFESIONAL NË MES TË SUNDIMIT
TË DOBËT TË LIGJIT

AUTOR Isuf Berisha REDAKTORE Brankica Petković
NDIHËSPREDAKTOR Saša Panić RECENSUESE
Amy Kennedy BOTUES Peace Institute, Institute for
Contemporary Social and Political Studies, Metelkova 6,
si-1000 Ljubljana, Slovenia, <<http://www.mirovni-institut.si>>. DIZAJNI DAK, Ljubljana, Nëntor 2016